



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 5

Prishtinë, më 16.6.2021, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Krasniqi, Arbëresha Kryeziu-Hyseni, Agon Batusha, Arjeta Fejza, Shqipe Isufi, Driton Hyseni, Blerta Deliu-Kodra, Time Kadrijaj, Fridon Lala dhe Branislav Nikoliq

Mungoi: Ardian Kastrati.

Deputet i interesuar, Alban Bajrami -LVV.

E ftuar: Albulena Haxhiu, ministre e Ministrisë së Drejtësisë, me bashkëpunëtorët.

Stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli dhe Safet Beqiri.

Pjesëmarrës të tjerë: Përfaqësuesi nga GLPS, GIZ, OSBE, KDI dhe përfaqësuesit e mediave

Mbledhjen e kryesoi: Rrezarta Krasniqi, kryetare e Komisionit

Kryetarja e Komisionit pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen.

Rendi i ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 2.6.2021;**
- 3. Raportim i znj. Albulena Haxhiu, ministre e Ministrisë së Drejtësisë;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja, pyeti anëtarët e komisionit nëse pajtohen që mbledhja të nis me raportim të ministres, për të vazhduar pastaj me pikat e tjera.

Pasi i uroi mirëseardhje dhe falënderoi ministren që i është përgjigjur ftesës, tha, se sundimi i rendit dhe ligjit është njëra ndër pikat më të rëndësishme, jo vetëm në procesin e integritit, por po ashtu edhe në funksionimin e shtetit dhe shoqërisë. Si anëtarë të këtij Komisioni ju kemi ftuar të raportoni lidhur me përmbushjen e obligimeve nga ana e Ministrisë së Drejtësisë sa i përket PKZMSA-së, si dhe ERA-së dhe zhvillimet e fundit në vend në fushën e drejtësisë, në mënyrë që të shohim se cilat kanë qenë të arriturat dhe ngecjet në këtë drejtim dhe të mundohemi që me një bashkëpunim me të madh institucional të avancojmë rrugën tonë drejt përmbushjes së obligimeve tona, pasi që siç e dimë, varësisht nga përmbushja e këtyre obligimeve kemi edhe avancimin e rrugës drejt integritit. Sa i përket sektorit të drejtësisë Raporti për Vendin gjen se: Kosova është në një fazë të hershme në zhvillimin e një sistemi gjyqësor që funksionon mirë. Administrimi i drejtësisë mbetet i ngadaltë dhe joefikas. Rishikimi Funkcional i Sektorit të Sundimit të Ligjit në vazhdim ka siguruar një bazë të shëndoshë për të reformuar dhe modernizuar aspekte të ndryshme të gjyqësorit. Qeveria duhet ta çojë përpara këtë punë.

Kosova është në një fazë të hershme, ka njëfarë niveli përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit. Në periudhën e raportimit, është arritur progres i kufizuar, përfshirë hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të nivelit të lartë, në konfiskimin e pasurive si dhe përmes krijimit të departamenteve speciale që trajtojnë rastet në lidhje me korrupsionin e nivelit të lartë (dhe krimin e organizuar) në gjykata.

Ndërsa, bazuar në planin e Qeverisë, Ministria e juaj ka paraparë si prioritete ndër të tjera edhe procesin e Vetëqyrtimit, strategjinë e drejtësisë dhe krijimin e një mekanizmi të veçantë për luftim të krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë, prandaj, sa besoni se do të mundeni që të adresoni këto të gjetura përmes këtyre proceseve.

Kurse, sa i përket procesit të liberalizimit të vizave, dua të di se ku jemi me këtë proces dhe nëse është kërkuar nga ju përmbushje edhe e ndonjë kriteri shtesë që ndërlidhet me luftimin e krimit dhe korrupsionit, kritere këto vendimtare në procesin e liberalizimit.

Albulena Haxhiu, ministre e Ministrisë së Drejtësisë, pasi falënderoi për ftesën, tha se padyshim raportimi para Kuvendit për Qeverinë e re të Kosovës është shumë i rëndësishëm dhe në këtë drejtim fuqizojmë bashkëpunimin ndërinstytucionalë, në raport me obligimet që i kemi.

Jemi të vetëdijshëm në këtë drejtim për sfidat që i kemi para vetes, në kuptim të sundimit të ligjit dhe besojmë fuqishëm që një ndër problemet më të mëdha, me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës, pa dyshim është mungesa e sundimit të ligjit dhe jo rastësisht kjo evidentohet edhe në Raportin për Vendin, por edhe në raporte tjera.

Një nga prioritetet e Ministrisë së Drejtësisë e që lidhen edhe me Agjendën e reformave evropiane dhe PKZMSA-së është rishikimi funksional dhe përmes këtij procesi janë evidentuar shumë probleme me të cilat aktualisht përballet sistemi i drejtësisë, por edhe ai i sigurisë. Në këtë proces kanë punuar kryesisht ekspertë të fushës dhe përfaqësuesit e Republikës së Kosovës, shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e ambasadave, e sidomos ata të Zyrës së BE-së, Ambasadës Amerikane dhe Ambasadës Britanike. Ky proces ka filluar vite më parë dhe duke pasur parasysh rëndësinë që ka i njëjti për Republikën e Kosovës, ne si Qeveri e kemi vu si prioritet dhe jemi duke punuar me intensitet që ta përmbysim strategjinë për sundimin e ligjit, e cila shumë shpejt do të votohet në Qeveri dhe lidhur me këtë kemi marr diku mbi 300 rekomandime nga institucionet përkatëse dhe shoqëria civile. Tani sfida pas miratimit të saj në Qeveri është implementimi i saj.

Si Qeveri jemi të përkushtuar që Kosova të jetë shtet i së drejtës, si ministre e Drejtësisë jam e shqetësuar sepse sa herë bëhet matje e opinionit publik në raport që qytetarët kanë me institucionet e drejtësisë, marrin besim jashtëzakonisht të ulët dhe ne e kemi për obligim ta ngrisim këtë besim. Në këtë drejtim, do ta veçoja Vetingun në sistemin e drejtësie dhe të sigurisë, por që ajo bie në kompetencën e MPB-së. Jemi duke punuar në Koncept dokumentin për Vetingun në sistemin e drejtësisë dhe dje kemi përmbyllur draftin e parë dhe i njëjti është dërguar te grupi i gjerë i anëtarëve për të dhënë komentet e tyre deri me 30 qershor të këtij viti dhe planifikojmë që miratimi të bëhet në fund të muajit gusht.

Do të fokusohemi në verifikimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në 3 aspekte: integritetin moral të tyre, në integritetin profesional dhe aspektin pasuror të tyre.

Më tutje është adresimi i luftës kundër krimit dhe korrupsionit, Kosova fatkeqësisht renditet ende në vendet e korruptuara. Sipas raportit të Amnesty international për vitin 2020, Kosova është renditur në vendin e 104-të dhe ka pasur 36 pikë, besoj që është koha e fundit kur ne duhet të dëshmojmë që luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit e kemi seriozisht, prandaj kemi vendosur fuqizimin e mekanizmave dhe pakos ligjore kundër korrupsionit.

Në këtë drejtim jemi duke punuar në hartimin e Projektligjit për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme, koncept dokumentin e kemi votuar në Qeveri dhe tani jemi duke punuar në hartimin e projektligjit dhe konsiderojmë që më së largu deri në shtator të dërgohet në Kuvend për votim. Qëllimi i këtij projektligji është që barra e provës të vendoset tek personi i dyshuar, kryesisht do të merret me nivelin e lartë të korrupsionit, në kuptimin që nëse një zyrtar ka pasuri në shpërputhje me të ardhurat që ka, atëherë mekanizmi përkatës të ketë të drejtën ta justifikojë pasurinë që e ka, nëse zyrtari nuk e justifikon pasurinë që e ka, atëherë i kërkon gjykatës që e njëjta pasuri të shqyrtohet dhe konfiskohet. Kanë qenë të pavërteta se agjencia do të konfiskoj pasuri, në asnjë rrethanë nuk do të bëjmë një gjë të tillë, sepse mund të cenohet siguria juridike dhe vetëm gjykatat kanë të drejtë të marrin vendim për konfiskim të pasurisë së pajustificueshme.

Po ashtu jemi të përkushtuar të fuqizojmë institucionet tona aktuale në luftën kundër krimit dhe korrupsionit, sidomos Prokurorinë Speciale, duke pasur parasysh se merret me nivelin e lartë të korrupsionit.

Me lejoni të ju njoftoj se baza aktuale ligjore, Ligji për zgjerimin e kompetencave që ka hy në fuqi para dy viteve, është zbatuar vetëm në një rast, prandaj kjo thërret për nevojat urgjente për adresimin e pakos ligjore kundër korrupsionit. Gjithashtu, adresimi i krimeve të luftës që parashihet në PKZMSA. Në këtë drejtim, me mbështetje të të gjithë deputetëve të Kuvendit, me përjashtim të Listës serbe, ne kemi arritur të ndryshojmë një dispozitë në Kodin e Procedurës Penale për gjykimin në mungesë të krimeve të luftës. Pas hyrjes në fuqi të këtij projektligji, do të ketë të drejtë të gjykimin në mungesë të kriminelëve të luftës.

Gjithashtu, kemi themeluar grupin punues për Institutin për Krimet e kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë. Siç jeni në dijeni, Kosova ende nuk ka një memorie institucionale për atë se çka ka ndodhur gjatë lufte se fundit në Kosovë. Jemi pajtuar që me rishikimin buxhetor, një pjesë të buxhetit të MD-së të ndahet për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në mënyrë që të njëjtat mjete të shkojnë në Prokurorinë Speciale, për shtimin edhe të 4 prokurorëve specialë brenda këtij viti, 6 bashkëpunëtorëve profesionalë dhe 2 përkthyesve, pra gjithnjë për nevojat e Departamentit për Krime të Luftës.

Tani është edhe çështja e dhunës në familje, që adresohet dhe e kemi obligim institucional. Konsideroj se dhuna në familje nuk është çështje private, pavarësisht tendencave për ta izoluar dhunën në familje, jam e shqetësuar për secilin rast të dhunës në familje, në secilin takim që kam pasur me përfaqësuesit e policisë, prokurorisë dhe gjykatave, kam evidentuar problemet që i kemi në këtë drejtim, sidomos me mosveprimin dhe adresimin e institucioneve përgjegjëse për krime të luftës, zakonisht gratë paragjykojnë me rastin e

raportimeve për rastet e krimeve të luftës. Ka një lëvizje të veprimit institucional në raport me këto raste. Sa i përket MD-së, kemi çështje të shumta që i kemi adresuar. Ka edhe shumë Projektligje që gjatë vitit 2021 do t'i procedojmë në Kuvend. Lidhur me çështjen e liberalizimit të vizave në këtë drejtim, ajo që mua më shprehet nëpër takime me përfaqësues ndërkombëtarë, ka të bëjë me adresimin e luftës ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe besoj që kjo është pengesa më e madhe. Franca dhe Holanda, janë dy shtete të cilat ende konsiderohen se kanë rezerva në raport me të drejtën e qytetarëve të Kosovës të lëvizin lirshëm. Së fundi, e kemi miratuar Rregulloren për sinjalizimin që është shumë e rëndësishme, sepse përmes kësaj rregulloreje, zyrtarët përbrenda institucioneve mund të raportojnë shkeljet e tyre dhe nëse të njëjtat nuk adresohen brenda institucioneve, mund të adresohen në Agjencinë Kundër korrupsionit dhe përmenda më herët një sërë masash që duhet të ndermirën, për të dëshmuar seriozitetin, për përkushtimin tonë në luftën ndaj krimit dhe korrupsionit, sidomos në nivele të larta të korrupsionit. Shumë prej zyrtarëve në Republikën e Kosovës, kanë krijuar pasuri marramendëse për një periudhë shumë të shkurtër para syve të institucioneve të drejtësisë.

Agon Batusha, tha se në Komision për Integritet Evropian kemi kompetenca për mbikëqyrjen e Qeverisë në aspektin e integriteteve evropiane dhe procesit të zbatimit të MSA-së. Sa e pamë, në raportin që e kemi dërguar dhe planin e punës për ligjet, udhëzimet administrative dhe dokumente të tjera, që janë ligjore brenda ministrisë dhe që kërkohen me agjendën e reformave evropiane dhe PKZMSA-së, del të jetë një agjendë e juaja tepër ambicioze dhe nëse realizohet, i bie që ne po bëjmë hapa gjigantë drejt procesit të integritetit në BE.

A do të duhet që për realizimin e këtij plani të ketë bashkëpunim edhe me institucione të tjera dhe sa janë bashkëpunuese institucionet tjera. Cilat janë sfidat dhe pengesat që ju i parashihni në realizimin e këtij plani ?

Pyetja tjetër ka të bëjë me Raportin për Vendin, i cili flet për numrin e madh të lëndëve të pazgjidhura nëpër gjykatat, si do të adresohet kjo? A keni ndonjë plan dhe si planifikoni të parandaloni grumbullimin e lëndëve të pazgjidhura nëpër gjykatat?

Blerta Deliu-Kodra, pasi që takimi është në Komision për Integritet, unë sot kam prituri që të jeni më e detajuar në fushën e specifikave në përmbushjen e PKZMSA-së, në atë se çfarë do të bëjë MD-ja në përmbushjen e objektivave të saj, sepse tani e kemi dëgjuar që përmbushja e kriterëve të vizave është e konfirmuar nga zyrtarët e lart të BE-së.

Meqë u zgjeruat në temat që nuk janë në fushëveprimtarinë e këtij Komisioni, unë do të lëshohem në disa pika. E përmendët që nuk është bërë mjaftueshëm në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, thatë se qeveritë e mëhershme nuk kanë qenë të fokusuara në këtë drejtim. Bazuar në Raportin e Vendit, ka pasur një progres, por Kosova llogaritet në fazën e hershme në luftën kundër krimit dhe korrupsionit. Kërkoj nga ju që ti adresoni gjetjet dhe çka do të bëni në këtë drejtim?

Ju sa keni qenë në opozitë, keni qenë kundër MSA-së dhe ndërkohë në planin qeverisës zotoheni se do ta zbatoni në plotëni PKZMSA-në dhe do të angazhoheni për forcimin dhe avancimin e marrëdhënieve tona në BE. A ka ndryshuar diçka prej atëherë, apo tashmë keni ndryshuar pozicionet dhe keni kuptuar se MSA-ja është kusht i shteteve për të negociuar dhe zbatuar atë.

Ju keni kundërshtuar edhe fusnotën, ndërkohë fusnota është e përfshirë në MSA ndërmjet Kosovës dhe BE-së, pra për çfarë bëhet fjalë? A do të punojë Qeveria prapë me fusnotë? Do të doja përgjigje në këtë drejtim.

Po i referohem programit politik të LVV-së në fushën e drejtësisë, ku thuhet ndër të tjera që synoni anëtarësimin e Kosovës në Konventën e Gjenevës dhe në Konventën kundër

gjenocidit, ndërkohë një premtim i tillë nuk gjendet në programin qeverisës, prandaj si do t'i qaseni ju kësaj.

Gjithashtu, në programin politik elektoral, ju keni premtuar krijimin e një Komision parlamentar të përhershëm për krimet e kryera gjatë luftës, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidin dhe dëmet e shkaktuara në Kosovë. Edhe ky premtim nuk ndodhet në Programin qeverisës dhe planin e ministrisë që ju e drejtoni. Ju si ministre keni rast që të keni takime të shumta me përfaqësuesit e BE-së, ne këto takime a përmenden kritere të reja për Kosovën ?

Driton Hyseni, tha se do doja të ndalesha pak tek procesi i Vetingut. Në çfarë faze jeni ju si ministri në këtë proces me njerëz të profilit të atyre personave që janë të përfshirë në bërjen e procesit të Vetingut në Kosovë? Gjithashtu, pasi që është një proces i rëndësishëm për sistemin e drejtësisë në Kosovë, të shoh edhe aspektin e bashkëpunimit me Kuvendin e Kosovës, qoftë edhe me partitë opozitare në këtë drejtim, me qëllim që procesi i Vetingut të merr një përfundim që e dëshirojnë të gjithë. Gjithashtu, një çështje që besoj se do të jetë e rëndësishme për investitorët e huaj është procedimi sa më i shpejt në Kuvend i Ligjit për Gjykatën Komerciale, që së bashku me Ligjin për investime strategjike dhe me legjisllacionin tjetër për mundësinë e të bërit biznes në Kosovë, të lehtësojë qasjen e investitorëve të huaj në Kosovë.

Albulena Haxhiu, ministre, tha se kemi proceduar në Ministrinë e Financave për mendim Projektligjin kundër korrupsionit dhe jemi në finalizim edhe të disa Projektligjeve tjera, për ti proceduar një herë në Qeveri dhe pastaj në Kuvend. Pajtohemi plotësisht me deputetin Batusha për agjendën ambicioze. Është e vërtetë sepse kemi jashtëzakonisht shumë probleme dhe jemi munduar që të nisim punën sa më parë për zgjidhjen e tyre. Në MD, kemi bashkëpunim të jashtëzakonshëm të kabinetit dhe stafit të MD-së, të cilët po punojnë me përkushtim në realizimin e prioriteteve që i kemi si Qeveri dhe zbatimin e afateve që i kemi paraparë në programin Qeverisës, agjendën legjisllative dhe obligimet që dalin nga dokumentet ndërkombëtare. Prandaj, në këtë drejtim jam optimiste se planifikimet tona do të jetësohen sepse të gjithë në MD jemi duke e dhënë maksimumin.

Sa i përket numrit të madh të lëndëve, më lejoni t'ju njoftoj se ne, çdo te premtë si MD, mbajmë takime me qytetarët dhe mund të theksojmë se 90% të kërkesave të tyre kanë të bëjnë me shqetësimet në raport me vonesat pranë gjykatave. Në këtë drejtim, aktualisht në Republikën e Kosovës, sipas shkallëve, gati 200 mijë lëndë janë ende të pazgjidhura, 456 lëndë janë në Gjykatën Supreme, 16898 lëndë janë në Dhomën e Posaçme dhe këtu duhet të shohim mundësinë që të bëjmë Gjykatë të veçantë administrative dhe të punës, por duhet që edhe Dhoma e Posaçme, që aktualisht vepron në kuadër të Gjykatës Supreme, të jetë në ndonjërin prej tyre.

Po ashtu, janë edhe 11242 lëndë në Gjykatën e Apelit dhe sipas komunikimeve nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kanë bërë një strategji në raport me zgjidhjen e numrit të lëndëve të pazgjidhura, që ata i konsiderojnë se nëse kanë kaluar më shumë se dy vite nga trajtimi i një lënde, atëherë konsiderohet lëndë e pazgjidhur. Prandaj, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, do të punojmë në këtë drejtim.

Gjykata Komerciale është po ashtu e rëndësishme sepse të gjitha lëndët në Gjykatën Themelore në Prishtinë, që lidhen me çështjet komerciale, dalin në Gjykatën Komerciale.

Në këtë drejtim Vetingu, i cili ka për qëllim edhe profesionalizmin edhe ngritjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve, do të ndikojë pa dyshim në adresimin e lëndëve të pazgjidhura.

Pyetjes së deputetit Hyseni, se ne cilën fazë jeni në çështjen e Vetingut, e përmenda edhe më parë që ne kemi finalizuar draftin e parë të koncept dokumentit për Vetingun dhe deri me 30 qershor presim komentet e grupit të gjerë. Profili i personave që janë përfshirë, janë përfaqësues të institucioneve të drejtësisë, MPB-së, policisë, AKI-së, përfaqësues të shoqërisë civile që marrin pjesë dhe përfaqësues të ambasadave. Për mua bashkëpunimi me partitë opozitare në këtë drejtim është shumë i rëndësishëm dhe kam kërkuar që të vjen edhe dikush nga radhët e opozitës, por sa jam në dijeni, nuk kanë shprehur interesim që të marrin pjesë, prandaj Komisioni ka vendosur që një deputet nga radhët e shumicës të jetë pjesë e këtij grupi punues.

Javën e kaluar kam dërguar ftesat te shefat e grupeve parlamentare, t'i takojë për të nisur bashkëpunimin për ndërtimin e konsensusit për Vetingun. Vetëm AAK-ja ka pranuar që të merr pjesë në takim, kurse PDK-ja dhe LDK-ja, nuk kanë pranuar. Neve nuk na pengon që të takohemi edhe me kryetarë të partive. Do të përpiqemi të takohemi me partitë që përfaqësojnë komunitetin shumicë në Kosovë, në mënyrë që t'i përfaqësojmë qëndrimet në raport me Vetingun në sistemin e drejtësisë. Për dallim nga Qeveria Kurti I, Prokuroria dhe gjykatat patën refuzuar të përfshihen, kurse tani ata janë të pranishëm dhe po e japin kontributin e tyre.

Sa i përket Projektligjit për Gjykatën Komerciale, dhe e kemi dërguar në Ministrinë e Financave për kosto buxhetore sepse konsiderohet se ka kosto buxhetore dhe kjo gjykatë është prioritet yni, për t'i nxitur investitorët nga diaspora dhe ata të huaj, për të investuar dhe të hapin vende të reja të punës. Kjo gjykatë do të luaj rol jashtëzakonisht të madh në zhvillimin e vendit.

Çështjet tjera, që adresoi znj Deliu, unë përmenda çështjet që dalin si obligim i Agjendës së Reformave evropiane dhe MSA-së, aq sa unë e di se nuk dola prej këtyre çështjeve, sepse secila prej çështjeve që përmenda, thash parashihen edhe në këto dy dokumente. Para pak ditësh kemi pasur takimin e Nënkomitetit për Liri, Drejtësi dhe Siguri, që organizohet nga Komisioni Evropian dhe secilën prej çështjeve që adresova këtu janë rekomandime nga BE-ja dhe ne kemi arritur vetë t'i shtyjme përpara dhe t'i parashohim edhe në agjendën e reformave evropiane.

Lidhur me çështjet e krimit të organizuar dhe korrupsionit, nuk është që vetëm unë e them që nuk ka progres në këtë drejtim, por kjo evidentohet edhe në dy dokumente që i përmenda, Raportin për Vendin dhe Departamentin Amerikan të Shtetit .

Po ashtu, nga organizatat e shoqërisë civile thuhet se në rastet e nivelit të lartë të korrupsionit ka mosveprim të institucioneve të drejtësie, edhe nëse ka veprime, ato janë qesharake me gjobë ose me kusht. Unë besoj që me pakon ligjore të re dhe me fuqizimin e kapaciteteve profesionale dhe njerëzore, në Prokurorinë Speciale, që merret direkt me luftimin e nivelit të lartë të korrupsionit, besoj që do të kemi avancime në këtë drejtim .

Znj Deliu po ashtu, adresoi çështjen që ne si opozitë asokohe kemi pasur rezerva për MSA-në pikërisht për çështjen e fusnotës. Asokohe na thuhej se do të shkrihet si flluskë bore, me të gjitha koncesionet që janë arritur, e kemi konsideruar të dëmshme dhe unë besoj që është koha e fundit që ne do të bëjmë përpjekje që ta fuqizojmë rolin e Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe ne këtë drejtim, kemi parë një qasje të re në raport me dialogun me Serbinë nga Kryeministri Kurti dhe zv.kryeministri Bislimi, aq sa kam dëgjuar, do të përgatitet edhe një raport për opozitën, po ashtu, edhe ju jeni të obliguar që të thirrni Qeverinë në interpelancë apo debate parlamentare, për ti adresuar të gjitha çështjet që dalin nga dialogu apo obligimet që dalin për anëtarësimin në BE.

Pra, fusnotën nuk e kemi vendosur ne dhe është fatkeqësi se aty mohohet shtetësia, prandaj edhe kemi pasur rezerva në atë drejtim. Prandaj çështjet që i kemi gjetur nuk mund t' i eliminojmë për 3 muaj, por duhet përkushtim serioz i të gjitha institucioneve për t' i eliminuar gabimet që i kemi bërë në të kaluarën.

Sa i përket Konventës për Gjenocid dhe atë të Gjenevës, këto janë shumë të rëndësishme, në mandatin e parë të Qeverisë Kurti kemi punuar në këtë drejtim dhe tani jemi duke bashkëpunuar me disa shtete që kanë fuqi të madhe me këta dy organizma dhe së bashku me MPJ-në, jemi duke bashkëpunuar, sepse sipas Ligjit për marrëveshje ndërkombëtare nevojitet bashkëpunimi me MPJ-në për anëtarësimin e Kosovës në këto dy Konventa.

Sa i përket çështjes së Komisionit Parlamentar që lidhet me krimet e luftës besoj që kjo është kompetencë ekskluzive e Kuvendit sepse Qeveria nuk mund ta themelojë. Ajo çka na përket neve si përgjegjësi, është Instituti i Krimeve të Luftës, fuqizimi i Prokurorisë Speciale për adresimin e krimeve të luftës, padia për gjenocid që është në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, që është shumë e ndjeshme dhe sfiduese sepse duhet të përgatitet në atë formë që mos të dështojë.

Kemi mjaftë argumente sepse ka pasur shumë masakra që Serbia i ka kryer në Kosovë. Konsideroj që ajo që nuk është bërë për 21 vite, pikërisht nga ata të cilët kanë qenë në ballë të luftës dhe kanë qenë në pushtet dhe janë thirrur në emër të luftës, nuk kanë bërë asgjë në këtë drejtim .

Sa i përket kritereve për liberalizimin e vizave, kritere të reja nuk ka dhe problemi i vetëm që adresohet në takime me ndërkombëtarë është veprimi serioz në adresimin e krimit dhe korrupsionit.

Blerta Deliu –Kodra, tha se ju keni qenë znj. ministre vet deputete dhe ju e dini se çështja e fusnotës nuk është çështje e votimit të partive, që ju i referoheni, por është vullnet i vendeve të cilat nuk e kanë njohur Kosovën. Unë do doja të dija vetëm konsistencën tuaj në qëndrime sepse ne po shohim çdo ditë sa jeni konsistent në qëndrime, edhe në raport me dialogun,. edhe në raport me fusnotën dhe asociacionin, pra nuk ka të re asgjë prej asaj çfarë ka proklamuar partia juaj deri sa ka ardhur në pushtet. Tani kur po përmendi çështjen e kompetencave, ju jeni ministre e drejtësie dhe ju e dini se programi i juaj qeverisës ka adresuar disa specifika dhe ka paraparë komisione, është obligim i juaj si Qeveri sepse keni marrë mandat që të krijoni edhe komisione. Tek çështja e Vetingut, ju udhëhiqni me Qeverinë dhe nuk mund ta thirrni nga një përfaqësues të opozitës pa u bërë një dakordim më specifik, pa një gjithëpërfshirje të spektrit politik dhe shoqërisë civile dhe nuk mund të kemi përzierje të kompetencave sepse Vetingu duhet të kalojë përmes Parlamentit, prandaj përfaqësuesit e opozitës kanë refuzuar t' i përziejnë kompetencat e tyre dhe të përfshihen në hartimin e koncept dokumentit nga Qeveria.

Për mua janë shqetësuese emërimet e fundit. Nesër e kemi në seancë plenare ratifikimin e 7 anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit, sa keni qenë në opozitë e keni pasur gojën plotë që duhet me të gjithë mekanizmat të luftohet nepotizmi, nuk është rasti vetëm i nipit të zv.kryeministrit, por është edhe rasti që edhe ne e kemi pasur në mbledhjen e fundit në Komisionin për Legjislacion. Në përbërjen e anëtarëve dhe të kryetarit të provimit të jurisprudences, ju jeni e informuar znj. ministre,

me propozimin e juaj, është propozuar Albert Zogaj, për kryetar të komisionit. Është raportuar se i njëjti mban 5 pozita zyrtare. Këto janë disa prej shqetësimeve në Qeveri, të cilat i kemi çdo vit në Raportin e progresit dhe të cilat adresohen edhe tash. A jeni ju që keni thënë, sa keni qenë anëtare e Komisionit të Legjislacionit se 5 anëtarët e komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës, nuk kanë përvojë të mjaftueshme. Çka janë këto ndryshime dhe pse duhen standardet të ndryshohen sapo të vijnë në pushtet apo pafundësisht t'i referoheni që ju për 20 vite e keni shkatërruar këtë shtet dhe ky është argumenti më i keq që ne vazhdimësi e bëni. Cili është komenti juaj për këto emërime që po ndodhin çdo ditë?

Driton Hyseni, lidhur me procesin e Vetingut, do të doja të kem një informacion lidhur me një proces paralel, që mendoj se duhet të shkojë në drejtim të asaj që mos të jetë vakant në sistemin tonë të drejtësisë, ku procesi i Vetingut mund të ketë efekt në kuadrin profesional, që është i angazhuar tani për tani në sistemin e drejtësisë, e që shihet se në shumë sfera ka dështuar në performancën e tij .

Time Kadrijaj, e paskeni një agjendë legjislative shumë të ngjeshur dhe besoj që do të mund ta realizoni, por ne si komision e kemi agjendën e reformave evropiane dhe zbatimin e MSA –së ,deri ku ka shkua dhe kur pritet të realizohet, ne e kemi pasur zv.kryeministrin, dhe ministrat me radhë do ti ftojme për të parë se sa kemi ecur, në mënyrë që mos të vendnumërojmë agjenda, të raportojnë për ta ndihmuar procesin e integriteteve evropiane.

Thatë se gjyqtarët dhe prokurorët do të merren me integritet moral dhe profesional, me çfarë shkalle e matni integritetin moral sepse nuk po mund ta kuptojë. Për integritetin profesional, duhet ta ketë kualifikimin adekuat, e moral nëse është në Vetëvendosje, moralisht është ne rregull, nëse jo, nuk i merrni. Mirë është që po e merrni seriozisht dhunën në familje sepse edhe në periudhën kur ke qenë deputete e kemi potencuar mjaftë, kemi mbajtur debate publike dhe kemi nxjerrë rezoluta, por fatkeqësisht lëndët e kësaj natyre nuk janë trajtuar me prioritet, edhe pse kemi kërkuar, po shihen rastet e vrasjeve që kanë ndodhur dhe ato raste janë lajmëruar në polici, por fatkeqësisht nuk janë trajtuar me prioritet dhe ka ardhur deri te vrasja.

Lidhur me liberalizimin, BE-ja dhe ne të gjithë e dimë se i kemi plotësuar kushtet për liberalizimin e vizave, kriteri i luftimit të krimit dhe korrupsionit nuk ka filluar sot, as nuk përfundon sot, por është një kriter i vazhdueshëm. Andaj ministre, cili është ai koncesion që do ta bëni për liberalizim të vizave, sipas raportueses për Kosovën që tha, t'ua japim liberalizimin e vizave sepse ma lehtë i pranojnë koncesionet. Për çfarë koncesionesh po bëhet fjalë sepse e keni premtuar reciprocitetin, por nuk ka reciprocitet dhe fatkeqësisht në dy takimet e fundit që i keni mbajtur, e keni pranuar mini Shengenin. Kjo nuk është në rregull sepse ju e keni kundërshtuar atë.

Albulena Haxhiu, ministre, tha se u adresuan shumë çështje dhe po shkoj me radhë, së pari ajo që u potencua nga znj.Deliu, më duhet të theksojë faktin se arsyeja që thashë që kemi trashëguar një gjendje të rëndë, qoftë në drejtësi dhe në të gjitha fushat dhe rrugëtimin tonë në BE, është për faktin se për këto përgjegjëse janë qeveritë e kaluara

dhe përgjegjësinë më të madhe për këtë e ka partia që ju e përfaqësoni dhe për këto ka folur qytetari i Kosovës më 14 shkurt, ju kanë dhënë mesazh të gjitha partive politike dhe na kanë dhënë mesazh të qartë edhe neve se nëse keqqeveerisni si këta e merrni ndëshkimin, prandaj këtë e vlerësojnë më së miri pas mandatit qeverisës. E kam vlerësuar shumë emancipimin shoqëror sepse kjo është fuqia që ka populli.

Prandaj, ne kemi trashëguar situatë të keqe dhe për çdo ditë, Kryeministri, së bashku me ministrat jemi duke punuar maksimalisht për t'i arritur synimet që i kemi para vetes .

Ne raport me këshillin që e përmendët, e keni pas zv.kryeministrin këtu, e keni adresuar dhe besoj që u sqarua. Ne kemi folur për abuzimet që janë bërë ne punësime, që janë hapur konkurse ku paraprakisht njerëzit veç janë punësuar, tani as ju as znj.Kadriu nuk mundeni me e ngritë këtë sepse ministrat në qeveritë e kaluara, kanë punësuar militantë partiakë ne shërbim civil dhe kjo ua ka mbytur shpresën qytetarëve sepse kanë aplikuar disa herë dhe nuk kanë mundur të punësohen.

Unë nuk do ta bëjë një gjë të tillë, secili konkurs që do të hapet në kuadër të MD-së, do te shkojnë më te mirët sepse i miri duhet vlerësuar në këtë vend, prandaj nuk besoj se keni shumë legjitimitet të flisni për punësimet dhe të tërhiqni paralele.

Kurse, sa i përket Komisionit të jurispodencës, unë nesër në seancë do ta sqarojë pikë për pikë, nuk është e vërtetë që z. Zogaj mban 5 pozita, ai është një ndër gjyqtarët më te mirë në Gjykatën Supreme dhe është anëtar i Këshillit Gjyqësor dhe vetëm këto dy pozicione i mban. Ne paraprakisht jemi konsultuar me disa organizata që e monitorojnë sistemin e drejtësisë dhe të cilat i njohin mirë prokurorët dhe gjyqtarët dhe ndër ta është vlerësuar profesionalizmi i z.Zogaj, e kam dërguar çështjen në Agjencinë Kundër korrupsionit dhe ata kanë theksuar se nuk ka konflikt interesi dhe z. Zogaj nuk do të kompensohet për punën si kryetar i Komisionit, po ashtu, edhe dy anëtar tjerë të komisionit nuk do të kompensohen dhe kjo asnjëherë më par nuk ka ndodhur, gjithçka është në përputhje me ligjin.

Çështjet tjera që u adresuan në raport me Agjendën evropiane dhe MSA-në gjegjësisht afatet kohore janë afate të ndryshme njëra prej tjetrës. E kam thënë edhe në fillim se do të mundohemi pikë për pikë, sipas afateve t'i zbatojmë sepse asnjëra prej tyre nuk ka afat të njëjtë .

Sa i përket gjyqtarëve dhe prokurorëve, unë nuk thash që do të mëremi me integritetin moral dhe profesional, por thash, kur të merret betimi, kriteret që do të vlerësohen nga komisioni i jashtëm për Veting në sistemin e drejtësisë, do të merren me integritetin moral të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe pasurinë e tyre. Si përcaktohet integriteti moral do të përcaktojmë kriteret për Komisionin, ne nuk do ta bëjmë, do ta bëjë një komision i pavarur komplet nga Qeveria, rrjedhimisht nga Ministria e Drejtësisë.

Sa i përket dhunës në familje, jam njësoj e shqetësuar sikurse edhe ju. Jemi duke e dhënë maksimumin për t'i kryer obligimet institucionale në raport me dhunën në familje. E përmenda, dhuna në familje është përgjegjësi institucionale. Jeta e gruas është shumë e rëndësishme për shoqërinë tonë .

Ne e kemi pasur në agjendë legjislative Projektligjin për dhunën në familje, sepse pas Konventës së Stambollit, që është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, do të hartohet projektligji, mirëpo, në koordinim me Komisionin për të drejtat e njeriut, kanë thënë se

e kemi në plan hartimin e projektligjit dhe ne ju kemi thënë se çka do që ju nevojitet, ju ndihmojmë dhe po marrim pjesë në Komision për hartimin e këtij Projektligji.

Po ashtu, në raport me strehimoret që strehojnë viktimat e dhunës në familje, që dalin edhe si obligim në Agjendën evropiane, aktualisht janë në organizatat e shoqërisë civile kurse vitin e ardhshëm jemi duke planifikuar këto t'i marrim në kuadër të institucioneve shtetërore sepse është përgjegjësi institucionale për ta bërë këtë.

Sa i përket çështjes së koncesioneve, nuk po di se për çka e keni fjalën, Qeveria jonë nuk është si qeveritë e kaluara ku kanë bërë koncesione në emër të liberalizimit të vizave. E dini shumë mirë çështjen e demarkacionit, ku na thoshin: votojeni demarkacionin me Malin e zi dhe i liberalizojnë vizat. Zotohem para juve si ministre e Drejtësisë, se asnjë koncesion nuk do ta bëjë për liberalizimin e vizave, sepse është e drejtë, i takon qytetarit të Kosovës s'kemi çka japim kemi dhënë mjaftë, sepse shumë koncesione janë bërë kundrejt Republikës së Kosovës, prandaj asnjë koncesion nuk do të flitet për çështje të brendshme të Kosovës. Unë ju inkurajova ta thërrisni Kryeministrin në interpelancë dhe ta adresoni për çështjet që ka diskutuar në Bruksel dhe pyesni për secilën çështje veç e veç.

Arbresha Hyseni- Kryeziu, para se të kaloj te pyetjet, më duhet te reagoj në disa të pavërteta që u deklaruan nga deputetja Deliu-Kodra, në të dyja rastet që ajo i përmendi, më duhet të them se as nuk ka raste të nepotizmit dhe as konflikt interesi, por thjesht janë deklarata të vazhdueshme të opozitës që po bëjnë përpjekje që ta devijojnë qëndrimin dhe veprimin e Lëvizjes Vetëvendosje, si në të kaluarën, si tani në Qeveri.

U apostrofuan qëndrimet tona që kanë të bëjnë edhe me MSA-në, besoj se është mjaftë i qartë qëndrimi i lëvizjes karshi MSA-së dhe kur flasim për fusnotën, këtu dhe kur këtë çështje e ngrit si shqetësim një deputete e PDK-së. Më e pakta që mund të bëjmë është që t'ia përkujtojmë është, që fusnota u imponua nga një ish- Kryeministër që vinte nga PDK-ja dhe jo nga shtetet e BE-së dhe problemin e 5 vendeve mosnjohëse të BE-së Qeveria e asaj kohe e zgjodhi, duke e pranuar pikërisht fusnotën. Kështu që këto janë krejt pasojat që po i bartim nga qeveritë paraprake për shkak se në vazhdimësi kanë bërë marrëveshje dhe kanë marrë vendime të dëmshme për vendin, ata madje kanë qenë të bindur që kjo do të ndodh dhe pasojat po i bartim ne, por mendoj se është e kotë që të bëhet përpjekje që krejt ky faj ti hidhet Qeverisë Kurti.

U përmend çështja e nepotizmit nga një deputete e AAK –së dhe një deputete e PDK-së. Më duhet t'ua përkujtoj që mos e harroni Post Telekomini e Kosovës që e pati marrë formën e kullës së Pizës, gati u rrëzua prej hallave e tezeve të Aleancës që janë punësuar aty, madje prej eksponentëve tuaj politikë edhe publikisht deklaroheshin se një gjë e tillë duket me qenë shumë normale. Ne nuk po e vazhdojmë një gjë të tillë dhe pikërisht pse nuk po e vazhdojmë një gjë të tillë, ju po kapeni pikërisht aty ku jeni kapur gjatë gjithë kohës. Kjo tregon vetëm fuqinë e argumenteve që ju keni karshi Qeverisë Kurti, prandaj besoj që është e kuptueshme dhe e papranueshme me u marrë me deklarata të tilla, nga dy deputete që vijnë prej partive politike që në fakt e kanë instaluar nepotizmin në Kosovë.

Lidhur me çështjen e Vetingut, desha të dijë nga ministrja se si inkorporohet Vetingu, a do të ketë ndryshime kushtetuese apo një gjë e tillë do të ndodh nëpërmjet ndryshimeve ligjore.

Pyetja tjetër ka të bëjë me Projektligjin për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, që e konsideroj se është një hap shumë i rëndësishëm që është ndërmarr nga MD-ja, a janë përfaqësuesit e BE-së pjesë e konsultimeve në raport me këtë projektligj, duke pasur parasysh se vitin e kaluar ka pasur rezerva sa i përket kësaj çështjeje.

Time Kadriaj, reagoi në diskutimin e parafolësës dhe tha se ne e kemi ftuar ministren për tu përgjigjur dhe ajo na u përgjigj në mënyrën më të mirë të mundshme dhe nuk është nevoja ju të përgjigjeni, përveç nëse ju ka bërë zëdhënëse.

Shqipe Jusufi, tha se kam hulumtuar gjetjet dhe rekomandimet në Raportin e Progresit, pikërisht në fushën e ministrisë që e drejtoni, i përgatita pyetjet, por me të marrë raportin me shkrim i cili ishte shumë transparent dhe me raportimin tuaj të detajuar ma keni lehtësuar sepse të gjitha i kam pasur lidhur me njoftimin nga ana juaj për Vetingin, për Projektligjin për Konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë pajustificuar dhe për shqetësimet tona për dhunën në familje.

I sqaruat paraprakisht të gjitha dhe unë po i tërheq pyetjet nga të gjeturat e Raportit të Progresit. Një rekomandim në fund, lidhur me Ligjin për trafikim me qenie njerëzore, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, të keni një koncentrim më të madh, dihet se është në pajtueshmëri me legjislacionin e BE-së, por vetëm të krijohet një zbatueshmëri më e madhe .

Arjeta Fejza, besoj se është një lajm i mirë për të gjitha gratë dhe vajzat dhe për ne që e përcjellim një agjendë të integriteteve evropiane, fakti se në raportin e dërguar nga ana juaj ka pika konkrete, të cilat lidhen me çështjen e dhunës në familje si dhe shohim që gjatë mbledhjes së komisionit ka deputetë që ngrisin këtë shqetësim . Andaj një ndër problemet më të mëdha tek çështja e dhunës në familje, është çështja e riintegritit të viktimave, dhe pyes se a planifikohet diçka konkrete në drejtim të riintegritit të viktimave të dhunës në familje ?

Ministrja : Sa i përket çështjeve që u adresuan nga deputetja Hyseni, që lidhen me Vetingun, me lejoni t'ju njoftojë që ne mandatin e kaluar në Qeverinë Kurti 1, dy prej proceseve që ka pasur rezerva nga BE-ja dhe kryesisht nga Ambasada Amerikane, ka qenë procesi i Vetingut , por pas zgjedhjeve të 14 shkurtit dhe mbështetjes së madhe për partinë që unë përfaqësoj, duket që janë pajtuar që ky është vullnet shoqëror dhe tani nuk ka më dilemë se a duhet apo nuk duhet të ketë Veting, por vetëm cila është mënyra më e mirë për t'i adresuar, prandaj në kuptim të kësaj, tani kemi mbështetjen edhe të BE-së edhe të Ambasadës Amerikane për këto dy çështje, ku janë të përfshirë në grupet punuese. Rezervat që kanë dalë edhe në media, kanë qenë të vitit të kaluar.

Ne takimin që kishim në Nënkomitetin për Liri, Drejtësi dhe Siguri, kërkesë nga BE-ja ishte që të përpiqemi që secila prej këtyre nismave të jetë në përputhje me Kushtetutën, në kuptim të të drejtave të njeriut dhe aktet tjera ndërkombëtare, po ashtu, sugjerohet që

të jemi në komunikim edhe me Komisionin e Venecias dhe nga ky komision kemi shumë opinione në raport me Komisionin e Vetingut në Shqipëri dhe ne duhet të mësojmë nga disa gabime që janë bërë atje që mos t'i përsërisim .

Çështja tjetër që u ngrit nga deputeti Driton, që mos të mbetet vakant sistemi, një prej problemeve më të mëdha që ka pasur Shqipëria ishte që shumë institucione të rëndësishme kanë mbetur jofunksionale, pikërisht për faktin që shumë prej bartësve të sistemit të drejtësisë nuk kanë kaluar Vetingun dhe kjo ka mbajtur për vite të tëra jofunksionale institucionet atje. Ideja e Vetingut është që të shkohet nga nivelet e larta hierarkike, në mënyrë që kushdo që nuk e kalon Vetingun, të largohet e të hyjë tjetri, por paraprakisht duhet të përgatitet edhe procesi i rekrutimit, në mënyrë që të futen në sistem gjyqtarët dhe prokurorët e rinj, në vend të atyre që nuk e kalojnë Vetingun.

Lidhur me çështjen që u adresua nga deputetja Arjeta, në raport për riintegrimin e viktimave nga dhuna në familje, i kemi marrë adresimet si MD në raport me dhunën në familje, siç janë: Strategjia dhe plani i veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje, Rifunksionalizimi i grupit koordinues ndërministrorë, që ka të bëjë me adresimin e dhunës në familje, zbatimin e Konventës së Stambollit dhe data baza e integruar që vepron në kuadër të MD-së, për rastet në dhunën në familje, gjitha këto politika lidhen edhe me çështjen e riintegrimin të viktimave dhe jemi duke punuar të gjejmë vende pune për këto viktimat sepse vetëm 14% e grave është pjesë aktive e tregut të punës.

Varësia financiare po i bënë gratë të durojnë dhunën sepse nuk kanë ku të shkojnë, shumë shpejt do të vjen në Kuvend për miratim Projektligji për ndihmë juridike falas që ka për qëllim mbrojtjen falas për viktimat e dhunës në familje. Përveç viktimës së dhunës, duhet të punojmë edhe me dhunuesin, në mënyrë që kur ata të dalin nga vuajtja e dënimit, të pranohen në shoqëri e jo të bëhen edhe me të dhunshëm.

Alban Bajrami, tha se e di që Ligji për financimin e partive politike ka hyrë te Zyra e Kryeministrit, por besoj që do të jemi të implikuar aty shumë si ministri për shkak se është një gjetje dhe shënim edhe në Raportin e Progresit, i cili është i ndërlidhur ngushtë edhe me rastet korruptive dhe të nepotizmin që ka ndodhur në Kosovë. Një statistikë, në sekuestrimin preliminar dhe jo final, gjithëherë sa herë ka pasur zgjedhje, ka rënë numri i sekuestrimeve. Besoj që ky ligj edhe pse ka hyrë në domenin e Zyrës së Kryeministrit, do të shkojë shpejt në Kuvend dhe MD-ja, do ta jepni kontributin tuaj.

Albulena Haxhiu, ministre, theksoi se Projektligji për financimin e partive politike është shumë i rëndësishëm dhe për aq sa jam unë ne dijeni ekziston një draft i cili pa dyshim që duhet të rishikohet sepse janë edhe disa çështje që duhet të adresohen dhe Agjencia për Sekuestrim dhe Konfiskim të Pasurisë, është në kuadër të MD-së, dhe pa dyshim se ne do ta japim kontributin tonë nëse ajo kërkohet .

Brenda këtij viti do të procedohet sepse ne e dimë problemin dhe kritikën që i marrim vazhdimisht në Raportin për Vendingun sepse nuk po auditohen financat e partive politike, prandaj duhet të hartohet ligji, ku duhet të dihet secili cent i qytetarit ku po shpenzohet .

Kryetarja, falënderoi ministren për raportimin, ndërkohë që ministrja u shpreh e gatshme të raportojë edhe në të ardhmen.

2.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt.26.5.2021

Lidhur me procesverbalin pati vërejte deputetja Arbëresha Hyseni –Kryeziu dhe Agon Batusha, të cilët kërkuan të plotësohet dhe në mbledhjen e radhës të miratohet.

4.Të ndryshme

Kryetarja, tha se ne Planin e punës kemi paraparë takimin me shoqërinë civile, andaj planifikojmë organizimin e një takim me përfaqësuesit e shoqërisë civile, me qëllim të rritjes së bashkëpunimit në procesin e integritimit.

Arbëresha Kryeziu- Hyseni, tha se i ka dy propozime: Komisioni për Integritim Evropian ende nuk e ka shqyrtuar Raportin për vendin për vitin 2020 dhe ne si Komision e kemi për obligim shqyrtimin e këtij raporti dhe dërgimin në seancë plenare. E kuptoj se ka ardhur në kohën kur ka rënë legjislatura e kaluar, megjithatë besoj që do të duhej të sillet për diskutim në komision Raporti për Vendin i vitit 2020.

Ne kur e kemi miratuar Planin e punës së komisionit, jemi dakorduar që çdo muaj të bëjmë nga një vizitë në njërin prej qyteteve të Republikës së Kosovës, ku do ta vizitojmë Zyren Komunale për Integritim Evropian, andaj është mirë që së bashku ta caktojmë se në cilin qytet të shkojmë për vizitë kësaj radhe, unë propozoj komunën e Ferizajt.

Kryetarja, tha pasi që nuk janë të gjithë anëtarët e komisionit prezent, kjo do të vendoset në mbledhjen e radhës, kur do të formohet një grup.

Por deputetët kërkuan të vazhdohet me votimin e këtyre propozimeve, pasi kishte kuorum .

Kryetarja e hodhi së pari në votim propozimin për ta vizituar komunën e Ferizajt dhe pas votimit konstatoi se Komisioni vendosi që kjo vizitë të bëhet të mërkurën.

Kurse, lidhur me diskutimin për Raportin për Vendin, Arbëresha Hyseni –Kryeziu, propozoi që të shqyrtohet edhe një herë ky propozim dhe pastaj të vendoset, kur të hedhet për diskutim. Për këtë propozim u pajtuan edhe anëtarët tjerë të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Rrezarta Krasniqi,
Kryetare e Komisionit
